



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGIJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 44, Datë 20.02.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 126, SERIA T11P, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGIJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “HEC-I DRAGOSTUNJE” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 5, gërma “ç”; nenit 6 dhe 7 të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 5.1, gërma “ç”, të “Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.02.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.02.2023, të përgatitur nga Grupi i Punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyerja ndaj ERE-s”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “HEC-I DRAGOSTUNJE” sh.p.k. është mbajtëse e licencës Nr. 126, Seria T11P, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 26, datë 10.03.2011, për një afat 30-vjeçar.
- Me vendimin e bordit nr. 124, datë 31.05.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.
- Vendimi i bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 07.07.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1225 prot., datë 21.07.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1607 prot., datë 20.09.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me Urdhrin e Kryetarit nr. 20, datë 30.01.2023, është ngritur Grupi i Punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.
- Rezulton se i licencuari “HEC-I DRAGOSTUNJE” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.
- Grupi i Punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë “HEC-I DRAGOSTUNJE” sh.p.k. shkeljen si vijon: *Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.*
- Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se, *për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 përqind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në gërmën ç) të nenit 42 parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.*
- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitorë ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të “Rregullores mbi përcaktimin e miratimit të pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, e ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.
- Duke qënë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qënë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, gërma “ç” dhe nenit 6 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017.
- Neni 6 i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.04.2017, parashikon se, *në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijani, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në*

*asnjë rast subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.*

- Në nenin 7 të Rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 126, Seria T11P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HEC-I DRAGOSTUNJE” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 26, datë 10.03.2011.
2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.
3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**